

Newsletter 1-2013

Rellinghauser Str. 22
45128 Essen

Tel.: + 49 (20 1) 75 99 85 28
Fax: + 49 (20 1) 75 99 85 29
E-Mail: info@i-de-al.org
Web: www.i-de-al.org

Një vështrim mbi Gjysmën e Parë 2013!

Amtsgericht: Essen VR 5251
Steuernr.: 112/5870/1294

Bankverbindung: Postbank
Kontonr.: 999 44 64 35
BLZ: 360 10 0 43

Präsidentin: Anduena Stephan
Vertretung: Alban Shehu

Essen, am 01.07.2013

I dashur Anëtar i **IDEAL**,

I dashur Mik i Shqipërisë,

Gjysëm-viti i parë 2013 ishte për ne dhe miqtë tanë një gjysëm vit i bukur dhe i mbushur me aktivitete.

Viti nisi me festën e bukur të 8 Marsit, Dita Ndërkombëtare e Gruas, në të cilën anëtarët e **IDEAL** dhe kolegët tona festuan së bashku në një pasdite të relaxuar në **Hammam Sahara** në Dyseldorf dhe më pas në një mbrëmje të bukur në Portin e Dyseldorfit në një ambient me kuzhinë mesdhetare, verë shqiptare dhe muzikë live. Tradita e bukur e festimit të kësaj dite që nisi vitin e kaluar këtë vit arriti një kulm të ri. Edhe në Mars të 2014 anëtarët e **IDEAL** dhe kolegët tona do të festojnë sërisht. Me iniciativën e tyre, festa e 8 Marsit në 2014 do të festohet në Kryeqytetin e Europës, **Bruksel** dhe do të shoqërohet mes të tjerave dhe me një vizitë në Parlamentin European.

Festa e Verës me 02.06.2013 ne Grugapark Essen

Me Iniciativë të shoqatës sonë **IDEAL** dhe në bashkëpunim të ngushtë me shkollën shqipe të Essenit dhe Gelsenkirchenit si dhe shoqatën Kulturore Sportive të Gelsenkirchen-it u festua Festa e verës dhe e Fëmijëve 2013. Pavjoni i mbuluar i Grugapark ishte zbuluar me tollumbace dhe flamurë shqiptarë, kosovarë dhe gjerman në mënyrë festive. Një pllakatë me mbishkrimi "**Gëzuar 1 Qershorin**, Festën e **Fëmijëve**" terhiqte vëmendjen e miqve dhe të ftuarve prezent në të.



Më shumë se **180 të ftuar** morën pjesë në këtë festë dhe shijuan kohën e bukur në parkun e mrekullueshëm të Gruga. Në qëndër të festës ishin rreth **100 fëmijë shqiptarë** të diasporës kryesisht nga qytetet e Essen dhe të Gelsenkirchen-it si dhe miq e të ftuar nga qytetet e tjera të NRW. Shumë fëmijë erdhën së bashku me motrat e vëllëzërit si dhe me miqtë e tyre në festë. Një numër i madh i tyre janë fëmijë të shkollës shqipe të Essenit dhe Gelsenkirchenit.



Aktivitetet të ndryshme u zhvilluan për të gjithë grupmoshat. Për më të vegjlit nxënëset e klasave të 9-12 të shkollës shqipe ofruan **zbukurime** dhe piktura me akualet, ndërsa për më të rriturit u zhvilluan aktivitete sportive si **badminton**, futboll, **volleyball** në rërë. Dy grupe të vajzave të shkollës shqipe të Essen-it dhe Gelsenkirchen-it kërcyen **valle popullore** dhe **hippop** shqiptare duke mrekulluar publikun me talentin dhe kostumet e tyre.



Edhe pjesa kulinare nuk mbeti pas: **IDEAL** si dhe Shoqata Kulturore Sportive e Gelsenkirchenit e cila kontriboi me një **donacion** prej 150-Euro për **nxënësit e shkollës shqipe** të Gelsenkirchen ofruan wafëra, sallamë të pjekur dhe shumëllojshmëri pijesh për të gjithë pjesëmarrësit. Shumë nxënës të shkollës shqipe ndihmuan aktivisht edhe gjatë festës dhe mundësuan realizimin me sukses të saj.



Një **falenderim i vecantë** me këtë rast i shkon Z. Naser Qerkinaj, Kryetar i Shoqatës së Gelsenkirchen-it dhe ekipin organizator të festës Anduena Stephan, Alban Shehu, Blerina Jorgaqi, Silva Reka, Vaso Janko, Gent Ishmaku, mesueses së shkollës shqipe të Gelsenkirchen-it **Etleva Persch**, të shkollës shqipe të Essen-it **Vitore Përgjoka** dhe të gjithë nxënësve dhe prindërve që na mbështeten në këtë festë.



Shumë **kontakte dhe miqësi të reja** u mundësuan mes fëmijëve, prindërve dhe miqve të ftuar. Në përfundim të festës shumë prindër shprehën dëshirën për të organizuar më shpesh dhe përsëri festa të tilla për të promovuar **integrimin e diasporës**, por dhe për të ruajtur **identitetin tonë** dhe për të mundësuar komunikimin mes brezave. 1 Qershori fitoi kështu një vend të përhershëm në kalendarin e aktiviteteve të **IDEAL** dhe për vitet në vazhdim.



Në fillim të **korrikut** ishin sërish fëmijët e shkollës shqipe në qëndër të vëmendjes sonë. Këtë herë në Gelsenkirchen në festën e Kulturave. Një kërcim shumë i bukur nga **grupi i vajzave** i dha më shumë bukuri festës. Flamuri shqiptar udhëhiqte flamujt e të gjithë kombeve të tjera që ishin të pranishme. Urime me këtë rast znj. Etleva Persch për këtë shfaqje.



Aktivitetet e Reja 2013 - Lutemi Shenoni në Kalendar!

IDEAL do të vazhdojë të organizojë dhe aktivitetet e tjera kulturore, sociale dhe ekonomike në mënyrë që të gjithë shqiptarët që jetojnë në NRW dhe miqtë e kombit tonë të kenë mundësinë të takohen dhe komunikojnë me njëri tjetrin.

Me mbështetjen e plotë të Ambasadës Shqiptare në Berlin **IDEAL** do të ofrojë në muajt e verës **Korrik** dhe **Gusht** në zyrat tona metodat e reja për mësimin e gjuhës shqipe, niveli 1-3. Ndërkohë ju kujtojmë dhe një herë se librat në shqip dhe librat e autorëve shqiptarë në gjermanisht mund të merren në cdo filjal të Bibliotekave të Essenit. Lista e Libra gjendet në aneksin bashkangjitur.

Me iniciativën e **IDEAL** në **Shtator** një grup të rinjsh (14-18 vjeçare) do të marrin pjesë në një takim me deputetët që mbulojnë rajonin e Europës Juglindore në Parlamentin e Landit të NRW si dhe do të vizitojnë këtë parlament. Ky aktivitet do të koordinohet së bashku me shkollat shqipe të Essen-it dhe Gelsenkirchen-it.

Në **Tetor IDEAL** do të marrë pjesë në Dialogun e Nivelit të Lartë të Kombeve të Bashkuara mbi strategjitë e Zhvillimit të Diasporave në Eschborn. **IDEAL** është një nga 50 shoqatat e përzgjedhura në diasporën e të gjithë kombeve që jeton në Gjermani që do të vazhdojë të marrë pjesë në këtë dialog dhe të japë kontributin e saj nga këndvështrimi i **diasporës shqiptare**.

Më 28. und 29. Nendor për herë të parë në NRW IDEAL do të lançojë Ditën e Dialogut mes NRW dhe trevave mbarëshqiptare të Shqipërisë, Kosovës dhe Maqedonisë Perëndimore në filarmoninë e famshme të Essen-it.

Ky event është i pari që sjell së bashku këto tre treva shqiptarofolëse në NRW për të shkëmbyer **mendime dhe eksperiencë** mbi bashkëpunimin ekonomik si dhe për të prezantuar **kulturën** dhe integritetin e **kombit** tonë. **IDEAL** është shumë krenar për mundësimin e një event-i të tillë në shkallë kombëtare i cili mbështet nga Qendra Internacionale për Migrim (CIM) dhe Shoqëria për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ).

Përveç konferencës një ditore të organizuar në bashkëpunim me Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë së Essen, Mühlheim, Oberhausen dhe NRW International si dhe Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë së Tiranës, për herë të parë do të mundësohet ekspozimi i produkteve „**Made in Albania**“ në NRW në një **panair** organizuar me këtë rast.



IDEAL
Integrative Deutsch-Albanische Gesellschaft

Kooperation | Kommunikation | Kultur

29 November 2013

NRW Dialogtag mit Albanien, Kosovo und Westmazedonien

Saalbau Philharmonie | RWE Saal | Essen
09:00 - 16:00 Wirtschaftsdialog
11:00 - 19:00 „Made in Albania“ Messe
16:30 - 22:00 Fest-Dinner mit Konzert

Në mbyllje do të ketë një koncert festiv dhe një darke festive me koncert Gala ku artistë shqiptarë dhe gjermanë do të luajnë pjesët më të mira të musikës **jazz**, klasike dhe **pop** si shqiptare dhe Gjermane. Shumë personalitete të Landit, Qytetit dhe Ministrive të Ekonomisë Shqiptare, të Ministrisë së Diasporës së Kosovës dhe Institucioneve Shqiptare të Maqedonisë do të jenë pjesëmarrëse. **Kështu dita e Flamurit do të mbetet një ditë e vecantë për 2013!**

Ejani me ne! Le të tregojmë së bashku **Vlerat** tona, të forcojmë **Kulturen** tonë dhe të shpalojmë **Vitalitetin** tonë!

IDEAL ju uron Mirëseardhjen si Anëtarë apo si Mik i kulturës dhe shpirtit shqiptar. Së bashku arrijmë më shumë!

Për informacione të mëtejshme na vizitoni në www.i-de-al.org.

IDEAL–isht
Juaji

Ekipi i **IDEAL**

IDEAL TEAM

Aneksi 1

Literturë Shqiptare në Bibliotekën e Essen-it

Ne gjuhen shqipe

Libra per Femije

- Bushaka, Gaço: Përrallat e shiut
- Bushaka, Gaço: Çufoja dhe Bubi Kaçurrel
- Bushaka, Gaço: Pushimet e Çufos
- Bushaka, Gaço: Filmi i gjeneral Çufos
- Bushaka, Gaço: Çufo president
- Grillo, Odhise K.: Lahuta e Malsisë

Romane

- Blushi, Ben: Otello, Arapi i Vlorës
- Blushi, Ben: Të jetosh në ishull
- Bulka, Nonda: Fabula në prozë
- Çajupi, Andon Zako: Vepra dramaturgjike
- De Rada, Jeronim: Këngët e Milosaos
- Zejno, Krenar: Këmba e të panjohurës

Publicistike

- Çabej, Eqrem: Shqiptarët midis Perëndimit dhe Lindjes
- Çabej, Eqrem: Diana dhe zana
- Cika-Kelmendi, Mimoza: Kosova si çështje europiane
- Cika-Kelmendi, Mimoza: Kadare ndryshe
- Ngjela, Spartak: Përkulja dhe rënia e tiranisë shqiptare
- Fevziu, Blendi: Enver Hoxha
- Kule, Virgjil: Gjergj Kastrioti Skënderbeu „Kryqtari i fundit“
- Pllumi, Zef: Saga e fëmijnisë
- Çabej, Eqrem: Hyrje në indoeuropianistikë

DVDs

- Virgjil Kule: Ionian romance [DVD]
- Virgjil Kule: Romance joniane [DVD]

Libra te Autoreve Shqiptare ne Gjermanisht

Romane und Publicistik

- Ahmeti, Mimoza: **Milchkuss**
- Ferra, Ilir: **Rauchschatten**
- Kadaré, Helena: **Eine Frau aus Tirana**
- Kongoli, Fatos: **Die albanische Braut**
- Kongoli, Fatos: **Hundehaut**
- Mustafaj, Besnik: **Kleine Saga aus dem Kerker**
- Ornela Vorpsi, Ornela: **Die Hand, die man nicht beißt**
- **Sowie die volle Kollektion der Bücher von Ismail Kadare**